



REPUBLIKA E SHQIPERISE

ORGANI KOMBËTAR I
INVESTIGIMEVE TË INCIDENTEVE
DHE AKSIDENTEVE AJRORE
NË AVIACIONIN CIVIL

Nr. 41 Prot., Date 30.05.2012

DREJTORIA E PERGJITHSHME
E POLICISE SE SHTETIT

Nr. 480/5 Prot., Date 30.05.2012

MEMORANDUM BASHKËPUNIMI

MIDIS

**ORGANIT KOMBËTAR TË INVESTIGIMEVE TË INCIDENTEVE DHE
AKSIDENTEVE AJRORE NË AVIACIONIN CIVIL TË REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË**

DHE

**DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË POLICISË SË SHTETIT TË
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

LIDHUR ME

**BASHKËPUNIMIN DHE ASISTENCËN NË RASTIN E NJË
INCIDENTI/AKSIDENTI TË RËNDË NË FUSHËN E AVIACIONIT CIVIL**

Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit dhe Organi Kombëtar i Investigimeve të Incidenteve dhe Aksidenteve Ajrore në Aviacionin Civil të Republikës së Shqipërisë të quajtura në vijim si "palët":

Në përputhje me pikën 5, të VKM nr. 686, datë 02.06.2010, "Për krijimin e Organit Kombëtar të Investigimit të aksidenteve/incidenteve ajrore në aviacionin civil", si dhe nenit 46 të ligj nr. 9749, datë 4.6.2007 "Për Policinë e Shtetit", duke respektuar dhe zbatuar të drejta dhe detyrimet përkatëse të njohura nga kuadri ligjor i Republikës së Shqipërisë;

Me dëshirën për të zhvilluar dhe forcuar marrëdhëniet bashkëpunuese në kuadër të ndihmes reciproke dhe asistencës, në kuadër të realizimit të objektivit të këtij Memorandumi Bashkëpunimi;

RANË DAKORD SI VIJON:

1. PËRKUFIZIME

AAC - Agjensia e Aviacionit Civil

AC - Aviacioni Civil

ANTA - Agjensia Nacionale e Trafikut Ajror

DPPSH - Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit

IND - Inspektori në Detyrë (OKIIA)
SHK -Specialist i Hetimit te Krimit (Kunder Akteve Terroriste)
MLP - Mjeku Ligjor Përgjegjës
RSH- Republika e Shqipërisë
TIA - Tirana International Airport
OBR - On Board Recording
OKIIA - Organi Kombëtar i Investigimit të Incidenteve/Aksidenteve

2. OBJEKTI

Memorandumi i Bashkëpunimi përcakton masat proceduriale për bashkëpunim dhe asistencë midis Palëve në përputhje me legjislacionin e RSH-së në rastin e një incidenti/aksidenti të rëndë në fushën e AC.

3. QËLLIMI

3.1 Qëllimi i këtij memorandumi është rritja e efikasitetit në kryerjen e detyrës e të dy Palëve, për investigim të plotë të çdo aksidenti/incidenti ajror, nëpërmjet kryerjes së shpejtë të procesit të investigimit dhe nxjerrjes së shkaqeve të aksidenteve/incidenteve ajrore.

a) njohur ngjashmërinë e qëllimit të OKIIA dhe DPPSH për të përmirësuar sigurinë e popullsisë dhe në të njëjtën kohë duke pranuar metodat të ndryshme që Palët përdorin për t'ia arritur këtij qëllimi.

b) minimizuar dyfishimin e mundimit dhe shmangien e një konflikti të mundshëm pa cenuar pavarësinë dhe funksionin e Palëve dhe për të inkurajuar një atmosferë konsultimi dhe bashkëpunimi për të siguruar që Palët të jenë të afta të kryejnë një investigim të saktë.

3.2 Terminologjia dhe nocionet e përdorura në këtë dokument, kanë të njëjtin kuptim ashtu si përkrahjet në legjislacionin e RSH-së.

3.3 Inspektorët e OKIIA kryejnë investigime teknike në fushën e AC. Qëllimi i çdo investigatori të OKIIA është parandalimi i aksidenteve në të ardhmen, nëpërmjet konstatimit të shkaqeve dhe rrethanave të aksidentit. Investigimi i OKIIA nuk ka për qëllim përcaktimin e përgjegjësisë dhe fajit.

3.4 Investigimet e OKIIA do të jenë në tre faza të ndryshme. Pasi të marrë njoftimin për një aksident, OKIIA do të vendosë se çfarë nivel reagimi është i nevojshëm. Ndodh shpesh që këto faza të mbivendosen dhe në rast të aksidenteve madhore mund të zhvillohen njëkohësisht.

1. Fazat e investigimit janë si mëposhtë:

a) Investigim Administrativ.

Në disa aksidente investigimi i Operatorit, Stafit, ANTA, AAC ose TIA mund të jetë i mjaftueshëm. Ky investigim mund të bëhet me korrespondencë ose me telefon.

b) Shqyrtimi paraprak.

Shqyrtimi paraprak është faza e parë e një investigimi të plotë. Qëllimi i tij është të identifikojë shkaqet dhe rrethanat e një aksidenti dhe të vlerësojë nëse plotësohen kriteret e nevojshme për të nisur një Investigim të plotë. Nëse në këtë fazë vendoset se nuk ka nevojë për një investigim të mëtejshëm, atëherë do të njoftohen të tërë Palët e përfshira.

c) Investigim i plotë.

Një ekzaminim paraprak mund të tregojnë se një investigim i plotë është i nevojshëm për të përcaktuar shkaqet e aksidentit. Ashtu si në një shqyrtimi paraprak, inspektori do të vazhdojë të mbledhë prova dhe të marrë në pyetje dëshmitarët, ose në raste fataliteti të afërmit.

Inspektori do të hyjë në detaje sa më shumë që të jetë e mundur dhe e nevojshme për të qenë në gjendje që të japë një raport të plotë dhe rekomandimet përkatëse për parrezikshmërinë.

4. MIRËKUPTIM I NDËRSJELLË

4.1 OKIIA pranon rolin e rëndësishëm të DPPSH në interesin publik dhe nevojën e saj që të jetë në gjendje të testoj çdo provë që vjen para tij në mënyrë të drejtë dhe të paanshme, në përputhje me e rolin legjitim, sipas legjislacionit të RSH-së.

4.2 DPPSH pranon rolin e rëndësishëm të OKIIA në interesin publik , bazuar në legjislacionin e RSH-së dhe nevojën e IND për të hetuar çështjet e sigurisë e transportit deri në maksimumin e mundshëm për të dhënë kontributin më të mirë për sigurinë në të ardhmen.

4.3 Secila palë duhet të krijojë një grup pune për të planifikuar dhe zbatuar shkëmbimet teknike dhe bashkëpunimin ndërmjet Palëve në fushën e investigimit të incidenteve/aksidenteve në AC. Këto shkëmbime teknike do të përfshijnë diskutime që synojnë thellimin e njohjes së aftësive investigative të Palëve, si dhe qëllimin e shtrirjes së çdo ndihme që mund të sigurohet në kushte të caktuara.

4.4 Shkëmbimi i bashkëpunimit midis palëve duhet të mbuloj gjithashtu edhe trajnim të përshtatshëm për stafin investigues duke përfshirë këtu edhe pjesëmarrjen në kurse trajnimi.

5. DETYRAT DHE PËRGJEGJËSITË

5.1 OKIIA do të njoftojë DPPSH sa më shpejt të jetë e mundur, pasi të jetë marrë një vendim për të nisur apo për të ndërprerë një investigim.

5.2 Palët do të qëndrojnë në kontakt lidhur me çdo incident/aksidenti që po investigohet nga të dy palët me qëllim që:

a) të shmangin dyfishimin e panevojshëm të përpjekjeve

b) të kërkojnë të bien dakord mbi procedurat e investigimit

5.3 Palët janë në dijeni të proceseve të investigimeve të njëri-tjetrit dhe secili do të punojë për të shmangur ndërhyrjen në efikasitetin e investigimit të njëri-tjetrit.

5.4 Menjëherë pas fillimit të një investigimi nga ana e OKIIA, në bazë të juridiksionit të njohur dhe përcaktuar nga legjislacioni në fuqi, OKIIA i kërkon me shkrim DPPSH të këshillohet (t'i merret opinion) përpara mbajtjes së një konference sipas këtij memorandum.

5.5 Investiguesit e OKIIA kanë kompetencë të investigojnë aksidente që përfshijnë ose ndodhin në bord të Operatorëve Shqipëtarë kudo në botë dhe të të gjithë operatorëve të çfarëdo kombësie qofshin në territorin e RSH-së. Këto kompetenca lejojnë ata që të hyjnë në çfarëdo ndërtese në RSH-së (TIA, ANTA, AAC), ose në bordin e ndonjë operatori Shqipëtar në mbarë botën, si dhe në bordin e çdo Operatori tjetër që është në hapësirën territoriale të RSH-së, me qëllim që të bëjë kontrollin ose inspektimin ashtu si inspektori e konsideron të nevojshme. Inspektorët e OKIIA kanë të drejtë të marrin në pyetje.

5.6 IND është anëtar i grupit të OKIIA i cili do të drejtojë Shqyrtimin Paraprak dhe çdo investigim të mundshëm që do të kryhet në vendngjarje. Ai është përgjegjës për ndjekjen e ngjarjes dhe për bërjen e një raporti të shkruar. IND do të zgjidhet në varësi të specifikave të aksidentit duke marrë në konsideratë fushën e tij të ekspertizës.

6. ÇËSHTJE LIDHUR ME VENDNGJARJEN E AKSIDENTIT

6.1 IND duhet të prezantohet sa më shpejt të jetë e mundur me SHK në vendngjarje.

6.2 IND duhet të njoftohet për çdo zhvillim lidhur me aksidentin dhe të përfshihet në të gjitha seancat e paraqitjes së gjendjes nga IND tek SHK.

6.3 DPPSH garanton që skena aksidentit apo rrënojave do të rrethohet e do të ruhet e paprekur sa më shpejt të jetë e mundur. DPPSH gjithashtu garanton që numri i njerëzve tek apo përreth mbeturinaave do të mbahet në një minimum absolut. Prova të rëndësishme mund të shkatërrohen nga njerëzit që mund të levizin rrënojat me qëllim të mirë ose duke lëvizur materialet nga pozitat e tyre origjinale. Është përgjegjësi e policisë për të ruajtur rrënojat dhe të ofrojë siguri fillestare për këtë vendngjarje. Niveli ruajtjes së dhe sigurisë së vendngjarjes duhet të rishikohet gjatë investigim dhe në veçanti në takimin e parë midis IND dhe SHK. Menjëherë pas kalimit të fazës së emergjencës, skena duhet të ruhet e paprekur sa më shumë të jetë e mundur deri në mbërritjen e IND.

6.4 SHK pranon që është e arsyeshme që IND dhe stafi i tij të hyjnë në vendngjarje në mënyrë që IND të kryejë detyrën e tij më së miri në përputhje me ligjin.

6.5 Të dyja Palët bien dakord për mbrojtjen dhe ruajtjen e provave në vendngjarje derisa çdo palë të ketë kohën e mjaftueshme për të kryer ekzaminimin e plotë të vendngjarjes.

6.6 Në shumicën e rasteve OKIIA do të lëshojë një urdhër mbrojtjeje për vendngjarjen duke kërkuar që provat nuk duhet të lëvizin përveç se me lejen e IND. Megjithatë, në rrethanat kur OKIIA nuk është në vendngjarje dhe konsiderohet nevojshme, do t'i jepet autoritet personit ose organizatës që do të konsiderohet se do të jetë në pozitën më të mirë për mbrojtjen dhe ruajtjen e provave. Kur SHK do t' i jepet ky autoritet, ai do të diskutojë me IND në telefon, mënyrën më të mirë për të ruajtur vendngjarjen e aksidentit dhe provat në vendngjarje.

6.7 Përveç rasteve që referohen në pikën 8 të këtij Memorandumi Bashkëpunimi, personat që ndihmojnë SHK nuk duhet të lëvizin asnjë provë (dëshmuere ose ndryshe). SHK pritet të mos kryejë asnjë veprim ose të trajtojë të gjitha sendet (dëshmuere ose çdo lloj tjetër), duke përfshirë çfarëdo pajisje regjistrimi, pa lejen e IND.

6.8 Aty ku është e nevojshme të prishen provat me qëllim heqjen trupave nga rrënojat, pritet që personat të cilët ndihmojnë MLP, aty ku është e mundur, të regjistrojnë të dhënat para se të ndër marrin këto veprime dhe t'ia vënë në dispozicion të IND ose OKIIA.

6.9 Të dyja palët bien dakord se para se provat e secilës palë të hiqen nga vendngjarja për shqyrtim ose testim të mëtejshëm, IND dhe SHK do të njoftohen si me natyrën e përgjithshme të ekzaminimit, gjithashtu edhe me rezultatet e tij.

6.10 Siguria e personelit në vendngjarje është e rëndësishme për gjitha Palët dhe si rrjedhim është dhe detyrë e tyre respektive që të marrin masa për sigurimin e jetës së stafit respektiv. Në mënyrë që të sigurohet një nivel i lartë sigurie, është shumë e rëndësishme që Palët të koordinojnë aktivitetet e tyre në çdo kohë.

6.11 IND do të njoftojë SHK kur OKIIA do të jetë dakord të heqë bllokimin e vendngjarjes.

7. AKSESI I PROVAVE TË MBROJTURA ME URDHËR

7.1 Kur ka një urdhër për mbrojtje të provave në një vendngjarje aksidenti¹, për shembull, për të parandaluar largimin e regjistruerit fluturimit nga rrënojat, aktivitetet e atyre

¹ Urdhër ky i lëshuar nga Prokuroria ose OKIIA

personave që ndihmojnë SHK në identifikimin dhe largimin e personave të vdekur në vendin e aksidentit, mbulohen nga legjislacioni në fuqi. Kjo do të thotë se nuk është e nevojshme të merret leje nga IND për të prishur provat në bazë të urdhrit të mbrojtjes, duke siguruar që veprimet e personave që ndihmojnë SHK ishin të nevojshme për identifikimin dhe largimin e personave të vdekur.

8. PYETSORËT DHE DEKLARIMET E LIRA

8.1 Ekipi investigues i OKIIA do të ketë përparësi në marrjen në pyetje të çdo personi të përfshirë ose të lidhur me një aksident.

Intervista e policisë, nëse kryhet nën ruajtje dhe / ose regjistrohet në video, në asnjë mënyrë nuk do të ndikohet apo dëmtohet vlefshmëria e saj në një gjykatë, sepse ajo ka ndodhur pas një interviste të kryer nga IND.

8.2 Gjatë një investigimit, një inspektor i OKIIA mund të marrë në pyetje çdo person të lidhur me një aksident, në veçanti ata të përfshirë në aksident ose dëshmitarë të aksidentit. Qëllimi i marrjes në pyetje nga një inspektor i OKIIA, është të identifikojë shkaqet dhe rrethanat, në mënyrë që të jetë në gjendje të nxjerrë rekomandimet dhe mësimet e sigurisë, me qëllim përmirësimin e sigurisë së AC.

8.3 Policia mund të marrë në pyetje këdo që konsiderohet si dëshmitar i një aksidenti dhe gjithashtu çdo person tjetër i cili mund të ketë informacione që kanë lidhje me investigimin e policisë. Qëllimi i marrjes në pyetje të policisë është të përcaktojë të vërtetën, të identifikojë shkakun e aksidentit dhe përcaktojë nëse është kryer vepër penale, duke e pasqyruar në referimin e vepres penale që i dergon Prokurorisë.

8.4 Jo të gjitha provat e mbledhura nga inspektorët e OKIIA mund të zbulohen. Kjo vlen kryesisht për marrjet në pyetje. Më e rëndësishmja, OKIIA nuk mund të japë çdo deklaratë të bërë nga dëshmitarët në një pyetësorë apo shënimet e inspektorëve që kanë të bëjnë me marrjen në pyetje². Në rastet e tjera, këto mund të merren vetëm me urdhër gjykatë.

9. AKSESI I PROVAVE FIZIKE NGA TË DY PALËT

9.1 Përcaktimi i një rruge efikase për ruajtjen dhe përdorimin e provave është e nevojshme. Gjithashtu tek provat duhet të kenë akses të dy Palët e përfshira në investigim.

9.2 Në raste të veçanta DPPSH, për qëllime investigimi, i kërkon me shkrim OKIIA, provat fizike që mbahen nga OKIIA. OKIIA bie dakort të vërë në dispozicion të DPPSH provat fizike për aq sa e lejon ligji duke:

a) i siguruar materialin në bazë të një kërkesë nga DPPSH kur ky material nuk i nevojitet më OKIIA.

² Përfshij këtu rastet kur çënohet siguria publike

b) i siguruar akses të materialeve për vëzhgimin /vlerësim nga SHK nën mbikëqyrjen e IND, duke përfshirë krijimin e mundësisë për DPPSH që të shohë testimin dhe ekzaminimin e kryer ose koordinuar përmes OKIIA.

9.3 OKIIA do të informojë SHK atëherë kur OKIIA synon që të ndër marrë ekzaminimin e provave fizike që mund të ndryshojnë statusin apo funksionimin e këtyre provave.

10. AKSES I IND NË PROVAT TEKNIKE

10.1 Inspektorët e OKIIA duhet të kenë kontroll mbi menaxhimin e të gjitha provave teknike. Ekspertiza e tyre dhe njohuritë e skenave të aksidenteve dhe në veçanti e infrastrukturës të të gjitha llojeve të avionëve do të mundësojë ata të identifikojnë dhe të mbledhin provat teknike me shpejtësi dhe duke shkaktuar dëme minimale gjatë largimit të tyre nga vendi. Kur ndonjë provë teknike është marrë në kujdestarinë dhe kujdesin e OKIIA, do të sigurohen parimet e ruajtjes së provave.

10.2 Inspektorët e OKIIA do të mbajnë shënime mbi mënyrën e levizjes, spostimit apo ekzaminimit të provave, në mënyrë që nëse i nevojiten SHK, të jetë e mundur vënia e tyre në dispozicion të tij. Në raste të veçanta SHK mund t'i kërkojë IND sqarime mbi shqyrtimin dhe ruajtjen e integritetit të provave.

10.3 OKIIA do të vërë në dispozicion të SHK rezultatet e çdo testimi që do t'u bëhet provave teknike. Në të njëjtën mënyrë, SHK do të vërë në dispozicion të IND çdo rezultat testimi që policia ka bërë lidhur me ngjarjen në fjalë. Kjo do të përfshijë testimet mjeko-ligjore, si dhe çdo testimi fizik të personave, ku testohet fryma apo ndonjë analizë tjetër që lidhet me gjakun, urinën ose të drogës.

10.4 Në rast se SHK i nevojitet akses në OBR për qëllime investigimi, atëherë SHK duhet ti drejtohet Drejtorit të Përgjithshëm të OKIIA me një kërkesë me shkrim.

11. AKSESI I IML NË INFORMACIONE TË REZERVUARA

11.1 Në rastet kur kërkohet akses në informacion të rezervuar, një kërkesë me shkrim ku ka një përshkrim të detajuar të llojeve të informacionit të kufizuar që është duke u kërkuar duhet të dërgohet tek Drejtori i Përgjithshëm i OKIIA, i cili përmbush aq sa është e mundur nga kjo kërkesë. Një kërkesë e përgjithshme për "të gjitha informatat në zotërim të OKIIA" nuk do të merret në konsideratë.

11.2 OKIIA do të përpiqet që të mbaj të informuar SHK, atëherë kur të jetë e mundur, mbi ecurinë e investigimit të OKIIA dhe llojet e informatave që janë marrë nga OKIIA (duke përfshirë informacionin që është planifikuar të mblidhet), gjatë një investigim të OKIIA me të cilin lidhet një investigim i SHK.

12. KOORDINIMI

12.1 Pike Kontaktit në OKIIA për zbatimin e këtij Memorandumi Bashkëpunimi është:

- Inspektori në Detyrë (OKIIA)

Rruga "Pashko VASA" 13/6

Tel.: +355 4 2244 472(Zyrë) +355 69 60 60 022

Fax: +355 4 2244 473

E-mail: info@okiiia.gov.al

12.2 Pike Kontakti në DPPSH për zbatimin e këtij Memorandumi Bashkëpunimi është:

- Sektori Kunder Akteve Terroriste/DPPSH
- Salla operative DPPSH 0694110196

13. PRINCIPET BAZË TË MEMORANDUM BASHKËPUNIMIT

13.1 Palët sigurojnë që do të ndërmarrin hapa të arsyeshëm që i gjithë stafi i tyre të familiarizohet me termat dhe kushtet e këtij Memorandumi Bashkëpunimi.

13.2 Palët mund ta ndryshojnë këtë Memorandum Bashkëpunimi në çdo moment duke rënë dakord midis tyre. Çdo ndryshim duhet të bëhet me shkrim dhe do të jetë një shtojcë e këtij memorandumi dhe hyn në fuqi në datën që bihet dakort në shtojcë.

13.3 Secila palë në çdo moment mund të shprehë me njoftim me shkrim qëllimin e saj për prishjen e këtij Memorandumi Bashkëpunimi. Memorandumi do të përfundojë në datën e caktuar në njoftim.

13.4 Ky Memorandum Bashkëpunimi hyn në fuqi menjëherë në datën që nënshkruhet nga të dy palët.

Drejtor i Përgjithshëm i OKIIA

Dipl.Ing. Arben XHIKU

Tirane, më 30.05.2010



Drejtor i Përgjithshëm i DPPSH

Hysni BURGAJ

